



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2020:111572

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05656885

**P.nr. 133/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në çështjen penale ndaj të akuzuarit E. B. nga fshati B., Komuna e Malishevës së bashku me mbajtësin e tij av. A. R. në P., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/II.nr. 896/2019 të datës 01.09.2022, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve në vazhdimësi nga neni 398 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, **më 02 maj 2024, nxjerr këtë:**

### **A K T V E N D I M**

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/II.nr. 896/2019 të datës 01.09.2022, dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të akuzuarit E. B. nga fshati B., Komuna e Malishevës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.nr. 896/2019 të datës 01.09.2022, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve në vazhdimësi nga neni 398 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Të dëmtuarit: A.B. nga fshati . Komuna e Rahovecit, e përfaqësuar nga av. Bahrije Xhyliqi; F. B. nga fshati B., Komuna e Rahovecit; L. S. nga fshati K. e M., Komuna e Rahovecit; F. P. nga fshati L., Komuna e Malishevës, për realizimin e kërkesave pasurore - juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykatë ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr. 896/2019 të datës 01.09.2022, kundër të akuzuarit E. B. nga fshati B., Komuna e Malishevës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/II.nr. 896/2019 të datës 01.09.2022, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve në vazhdimësi nga neni 398 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi shqyrtoi shkresat e lëndës dhe duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka konstatuar se në këtë çështje penale ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes penale, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, vepra penale është kryer gjatë majit janar 2018, ndërsa për këtë vepër penale ligjvënësi ka paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Sipas nenit 106 par.1 nën par. 1.5 të KPRK-së, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret për veprën penale e cila është e dënueshme me dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, nëse kanë kaluar *“tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale, të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim”*, kurse sipas nenin 107 par. 8 të KPRK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës se afatit të parashkrimit, parashkrimi absolut i ndjekjes penale ka ardhur në janar 2024.

Vendimin mbi kompensimi e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit, është marrë në bazë të nenin 453 par.1 të KPP-së.

Konform nenit 462 par. 1 dhe 3 të KPP-së, të dëmtuarit janë udhëzuar në kontest civil.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë, gjykata konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të akuzuarit të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale, prandaj në vështrim të nenit 106 par. 1 nën par.1.5, 107 par. 8 të KPRK-së, si dhe nenit 248 par.1 nën par.1.3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P. nr. 133/2022, më 02 maj 2024**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Njazi MORINA**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tre (3) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.